

PHI LAN THR OPY

edicioni 10

*Hapësirë e dedikuar mbështetjes së
nismave komunitare dhe kauzave sociale*

#philanthropy

— kontakt:   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI LAN THR OPY

*Hapësirë e dedikuar mbështetjes së
nismave komunitare dhe kauzave sociale*

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - qershor 2025

19

Rrathë Dhurues

26

Smile.ai

Publikohen tre
iniciativa të reja

28

**Intervista me
përfaqësues të nismave
filantropike në vend**

Z. Leonard Olli
"Korçarët Ndihmojmë Korçarët"

37

**Fushata në ndihmë të
personave në nevojë**

41

**Fondacionet
Komunitare**

Infrastruktura për të
ardhmen

44

**Zhvillimet nga Rrjeti
WINGS**

Solidariteti i filantropisë

Mirë se vini në edicionin e dhjetë të revistës Philanthropy!

Revista "Philanthropy" tashmë prej pesë vitesh, vijon të jetë një burim i rëndësishëm informacioni mbi zhvillimin e aktivitetit filantropik në vend.

Partnerët Shqipëri vijon punën e saj në drejtim të monitorimit mujor të **aktivitetit filantropik** përmes medias dhe platformave online, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të panoramës filantropike në Shqipëri. Në këtë seksion do të njiheni me fakte dhe të dhëna mbi aktivitetin filantropik në vend për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

Eventi "**Rrathë Dhurues**", rikthehet në vëmendjen e publikut përmes shpalljes së **Thirrjes Nr. 7 për Aplikime** për organizatat e shoqërisë civile të cilat synojnë të sjellin ndryshime të qëndrueshme në komunitet. Në këtë edicion ju prezantojmë gjithashtu me rezultate të punës së organizatave të mbështetura nga eventit "Rrathë Dhurues 2024".

R
r
a
t
h
ë
D
h
u
r
e
s



Platforma **Smile.al** ka shpallur Thirrjen për Projekt Propozime, e cila targeton organizatat në të gjithë vendin. Gjatë kësaj periudhe tre iniciativa të reja komunitare u shpallën në platformë dhe në këtë edicion do të njiheni me to.

Në këtë edicion të revistës, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me **Z.Leonard Olli**, drejtor ekzekutiv i fondacionit të parë komunitar në Shqipëri "Korçarët Ndhimojmë Korçarët", i cili do të ndajë me ne rrugëtimin për themelimin e tij.

Njihuni me të rejat nga takimi global **"Infrastruktura për të Ardhmen"** i organizatave mbështetëse për fondacionet komunitare, i organizuar gjatë muajt prill në Rumani.

Fushatat e ndërmarra në ndihmë të grupeve në nevojë adresojnë çështje me rëndësi për komunitetet që tragojnë.

Në kuadër të reduktimit të ndihmës së huaj, rretet filantropike ndërkombëtare, përfshirë **WINGS**, shprehin shqetësimin e tyre për situatën dhe theksojnë nevojën për solidaritet të shtuar dhe përpjekje të përbashkëta në këtë drejtim.

Sygjerimet dhe komentet tuaja mbi artikujt e këtij edicioni apo propozimet për edicionin e radhës janë të mirëpritura duke kontaktuar në adresën erexhepi@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A R R E T H A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K

J A N A R - Q E R S H O R 2 0 2 5


Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri **gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2025**, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale, si dhe përmes raportimeve dhe publikimeve të institucioneve publike dhe jopublike. Raporti analizon fushat dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, numrin dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik të dhuruesve dhe përfituesve, etj.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij. Gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2025, u regjistrua një numër prej **48,600 dhurimesh** me një vlerë dhurimi prej **250,062,857 Lekë** (2,567,380 Euro).


Krahasuar me të dhënat e gjashtë muorit të parë të vitit 2024, vihet re një rënie si në numrin, ashtu edhe në vlerën e dhurimeve filantropike. Konkretisht, numri i dhurimeve u ul me rreth 25% (nga 65,008 në 48,600), ndërsa vlera totale e dhurimeve shënoi një rënie prej afërsisht 11% (nga 281,546,539 Lekë në 250,062,857 Lekë).

Numri i dhurimeve sipas natyrës

- Monetare (99.67%)
- Mallra/Produkte (0.15%)
- Punë Vullnetare (0.09%)
- Shërbime Profesionale (0.08%)
- Miks (0.01%)



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë



Dhurimet sipas formës

Fjalorth


Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

Vlera e dhurimeve sipas formës

50 dhurime në formë të **Drejtëpërdrejtë**

56 dhurime përmes **Eventeve**

48,494 dhurime përmes **Fushatave**



Dhurim i drejtëpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme.

3 DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins (26)
- #2 TIKÀ Tiranë (20)
- #3 One Albania (15)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#Dhurues Individë 14,484,060 Lekë

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Bamirësia që Ndriçon – Shtëpi për Jetimët!", në mbështetje të pesë familjeve me jetimë që jetojnë në kushte të vështira.

#Dhurues Individë 13,897,520 Lekë

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Ndihmoni djemtë e Etleva Ruçit të kenë një shans për të luftuar", në mbështetje të dy djemve që vuajnë nga një sëmundje gjenetike, prej së cilës babai i tyre ka ndërruar jetë para dy vitesh.

#Dhurues Individë 12,494,599.5 Lekë

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Të shpëtojmë jetën e Amarildos 16 vjeçar me leuçemi!", në mbështetje të Amarildos, i cili ndodhet në gjëndje të rëndë shëndetësore.

Fushata për ngritjen e fondeve

229

Thirrje për Dhurime

77

Fushata përmes Medias Sociale & Platformave Crowdfunding

27

Fushata përmes platformave Crowdfunding

13

Megafushata

2

Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*


Evente

56

Evente live


*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*



*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit




Përfituesit Përfundimtar



- Publik i gjerë (56%)
- Fëmijë dhe të rinj (38.5%)
- Individë/Familje (5%)
- Tjetër (0.5%)



- Publik i gjerë (34.4%)
- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (31.83%)
- Komunitet fetar (21.35%)
- Komunitet minoritar (12.39%)
- Zonë specifike (0.03%)




- Të moshuar (40.33%)
- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (31.6%)
- Gra dhe Fëmijë në risk (28.07%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (77.19%)
- Të talentuar (12.7%)
- Fëmijë dhe të rinj (4.71%)
- Komunitet minoritar (4.47%)
- Zonë Specifike (0.92%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025, **99.7%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



*Tepelenë, Gjirokastrë, Vlorë, Sarandë, Mat.



E panjohur



0.25%

Kosova




0.03%

Shtete të tjera





0.02%




Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

84.13% e dhurimeve janë kryer nga dhurues nga Shqipëria, ndërsa pjesa tjetër nga diaspora dhe shtete të tjera.



* *Korçë, Lezhë, Lushnjë, Vlorë, Sarandë.*



Diaspora



15.23%

E panjohur



0.47%

Shtete të tjera



0.16%

Kosova




0.01%

Qëllimi i dhurimit


Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024 **3** fushat kryesore të dhurimeve janë si më poshtë:

- Shëndetësi
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Aktivitete humanitare me bazë fetare
- Tjetër



Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: Zbutjen e varfërisë (0.77%), Edukimin (0.15%), Zhvillimin ekonomik (0.08%), Art dhe kulturë (0.07%), Sport (0.02%), Trashëgimi kulturore (0.02%), Infrastrukturë publike (0.01%), Ruajtjen dhe mbrojtja e mjedisit (0.01%), Zhvillimi komunitetit (0.01%), Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore (0.01%) Shkencë (0.01%) etj.

Kanalet e dhurimit





A word cloud graphic featuring the number '451' in large black font. Surrounding the number are various media-related terms in red, including 'ARTIKUJ', 'EMISIONE', 'LAJME', 'REPORTAZHE', 'KRONIKA', and 'POSTIME'. The words are arranged in a circular pattern around the central number. Below the number, the text 'lajme në media' is written in bold black font. The entire graphic is flanked by two solid red rectangular blocks.

451

lajme në media

Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2025, u gjetën 451 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushata dhe iniciativa dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.

Njëkohësisht, media vizive ka prodhuar një numër të konsiderueshëm emisionesh dhe reportazhesh të fokusuara në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

R R A T H Ë D H U R U E S

“Rrathë Dhurues” është një event i përvitshëm i organizuar prej vitit 2018, i cili u jep individëve, bizneseve dhe institucioneve mundësinë të kontribuojnë përmes dhurimeve në vlerë monetare, materiale dhe asistencë teknike në mbështetje të nismave që adresojnë nevoja të ndryshme komunitare.

“Rrathë Dhurues 2024” mbledhi së bashku individë, biznese dhe organizata të shoqërisë civile, të cilët falë mbështetjes së tyre në vlerën prej **2,248,340 Lekë**, kontribuan në zbatimin e tre nismave të reja në Rrëshen, Durrës dhe Tiranë.

Ju ftojme të njiheni me ndryshimet që kanë sjellë zbatimet e këtyre nismave:



#RrathëDhurues
Shqipëri

ArtLab - Laboratori i Qeramikës dhe Pocerisë

Vlera totale e dhurimit: **1,054,880 Lekë** si dhe shërbim profesional falas.

Numri total i dhuruesve: **27** (10 individë; 10 biznese dhe 7 OJF).

Organizata zbatuese: **Përtej Barrjerave**

Më 30 maj 2025 u inaugurua "ArtLab - Laboratori i Qeramikës dhe Pocerisë" në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë në Tiranë. ARTLAB është më shumë se një hapësirë, është një mundësi për të mësuar, aftësuar dhe krijuar produkte qeramike.

Tashmë, 83 fëmijë dhe të rinj, mësojnë dhe ushtrohen në këtë ambient për të krijuar dhe ekspozuar produktet e tyre.



Këndi Miqësor

Vlera totale e dhurimit: **485,760 Lekë** si dhe libra falas.

Numri total i dhuruesve: **19** (8 individë; 6 OSHC dhe 5 biznese).

Organizata zbatuese: **Qendër Edukimi Lunah**

Ndërtimi i "Këndit Miqësor" i inaguruar pranë Spitalit Pediatrik Durrës në qershor të këtij viti e bën eksperincen e çdo fëmije që merr shërbime pranë këtij spitali më pak traumatike.

Këndi Miqësor është një hapësirë e ngrohtë dhe rekreative, e cila ndihmon në reduktimin e frikës ndaj shërbimeve shëndetësore dhe përmirëson përvojën e fëmijëve gjatë qëndrimit në spital.



Harmonia e Fëmijërisë

Vlera totale e dhurimit: **717,700 Lekë** si dhe materiale dedaktike e teknologjike.

Numri total i dhuruesve: **17** (4 individë, 6 OSHC dhe 7 biznes).

Organizata zbatuese: **Opportunity, Balance & Overcoming**

Që prej 9 prillit të këtij viti, rreth 700 fëmijë dhe të rinj të qytetit të Rrëshenit frekuentojnë ambientin e ri "Harmonia e Fëmijërisë" një qendër ditore me ndikim në zhvillimin social, emocional dhe edukativ të tyre.





THIRRJE E HAPUR PËR PROJEKT PROPOZIME



Në vijimë të kësaj iniciative, Partnerët Shqipëri hap thirrjen e rradhës për të gjitha OJF-të që kanë interes për tu bërë pjesë e eventit Rrathë Dhurues 2025.

Afati i fundit i aplikimit **1 gusht 2025**





S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Platforma Smile.al ofron një mundësi tjetër për mbledhjen e fondeve online, në mbështetje të nismave komunitare në fushat e shëndetit, solidaritetit, trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit e trajnimit, dhe aktivitetet sportive.

Si çdo vit, platforma lançoi thirrjen e rradhës e cila qëndroi e hapur deri më 30 Qershor 2025. Së shpejti do të shpallen edhe nismat fituese.

Ndërkohë, ju ftojmë të njiheni me **tre iniciativat më të fundit** të publikuara në platformë, të cilat vijojnë të kërkojnë mbështetjen tuaj.

3 INICIATIVATE REJA



Edukim dhe Punësim për të Tejkualuar Varfërinë dhe Stigmatizimin.

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri po fuqizon 50 të rinj Rom përmes aftësisht profesional, duke synuar punësimin e 30 prej tyre dhe mbështetjen e 10 të tjerëve për të krijuar startupe.

Kjo iniciativë synon integrimin ekonomik dhe social të komunitetit Rom, duke luftuar varfërinë, diskriminimin dhe përjashtimin. Bashkohuni me ne për të ndërtuar ura shprese dhe bashkëjetese. Dhuro tani në [Smile.al](https://smile.al) dhe jep një mundësi të re për të rinjtë Rom!

Së bashku bëjmë ndryshimin!

Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#).



Krijimi i një laboratorit të Lëndëve Biologji dhe Kimi

Me këtë nismë synohet krijimi i një laboratorit modern për lëndët Biologji dhe Kimi në shkollën 9-vjeçare "Koto Hoxhi". Ky investim hap mundësi reale për zhvillimin e njohurive praktike dhe nxit interesin e nxënësve për shkencat. Laboratori do të shërbejë si bazë për formimin e talenteve të moshës 10-15 vjeç, duke i përgatitur për një të ardhme më të sigurt në fushën e kërkimit dhe shkencës.

Çdo kontribut për realizimin e këtij projekti është një investim në cilësinë e arsimit dhe të ardhmen e brezave të rinj.

Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#).



Çfarë ajri thith unë?

Tirana përballlet me ndotje të lartë të ajrit, kryesisht nga trafiku dhe ndërtimet. Projekti synon të masë dhe monitorojë ndotjen (PM2.5 dhe PM10), të publikojë të dhënat për publikun dhe autoritetet, dhe të vlerësojë ndikimin në shëndetin e qytetarëve.

Nëpërmjet informimit dhe edukimit, projekti synon të nxisë ndërgjegjësimin dhe veprimet për një mjedis më të shëndetshëm.

Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#).

I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D



M B Ë S H T E T J E
P Ë R
K O M U N I T E T I N

Leonard Olli



Drejtör Ekzekutiv i Fondacionit Komunitar
"Korçarët Ndihamojmë Korçarët" (KNK)

Z. Leonard Olli është Drejtör Ekzekutiv i Fondacionit Komunitar "Korçarët Ndihamojmë Korçarët" (KNK), i cili u prezantua në Korçë në dhjetor 2024 si fondacioni i parë komunitar në Shqipëri. Ky fondacion synon të ringjallë traditën e filantropisë që ka origjinën në qytetin e Korçës dhe të forcojë solidaritetin brenda komunitetit lokal dhe me diasporën korçare.

Si lindi ideja për krijimin e fondacionit të parë komunitar në Shqipëri? Pse menduat se Shqipërisë i nevojitej një fondacion komunitar?

Ideja për krijimin e fondacionit komunitar është thellësisht e lidhur me traditën e pasur filantropike të Korçës, një trashëgimi që rrënjët i ka në fund të shekullit XVIII dhe fillimet e shekullit XIX. Frymëzimi erdhi nga Dr. Yvonne Naum, e lindur në SHBA nga prindër korçarë, e cila gjatë vizitës së saj të parë në Shqipëri, në vitin 2019, ndjeu nevojën për të bërë diçka të dobishme për Korçën dhe korçarët.

Pavarësisht vonesës së shkaktuar nga pandemia, ajo vendosi të dhurojë të ardhurat e saj për Korçën dhe, në bashkëpunim me Global Albanian Foundation, nisi përpjekjet për të mbështetur OJF-të lokale në realizimin e projekteve me ndikim në komunitet. Më pas, në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri dhe të frymëzuar nga praktikat më të mira në SHBA dhe Angli, kjo nismë mori formën e një fondacioni komunitar, një strukturë efikase dhe e përhapur ndërkombëtarisht në fushën e organizatave jofitimprurëse.


Në vitin 2024, kjo iniciativë u formalizua me themelimin e fondacionit të parë komunitar në Shqipëri. Fondacioni “Korçarët Ndhimojmë Korçarët” synon të mbështesë OJF-të lokale, të organizojë aktivitete për mbledhje fondesh dhe të shërbejë si zë i komunitetit në një realitet ku ky zë shpesh mbetet i panjohur apo i neglizhuar. Më shumë se një mekanizëm financimi, fondacioni synon të nxisë frymën e dhurimit dhe përkushtimit ndaj komunitetit.

Ndjem krenar që, së bashku me Dr. Yvonne Naum, Alda Nikollorin dhe Ardit Konimin, kemi themeluar këtë fondacion që përfaqëson një hap të ri dhe të domosdoshëm drejt përfshirjes aktive të komunitetit në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.





Disa nga aktivitetet
e #KorçarëtNdhimomëKorçarët



Cilat kanë qenë sfidat kryesore gjatë themelimit të fondacionit?

Themelimi i fondacionit ka patur disa sfida, por të gjitha të kapërcyeshme me përkushtim dhe bashkëpunim. Në fillim, ishte e rëndësishme të njihnim më mirë mënyrën se si funksionojnë fondacionet komunitare në kontekste të tjera, si strukturohen, si ndërtojnë besimin me komunitetin dhe si sigurojnë mbështetje të qëndrueshme. Kjo ishte një fazë orientuese e rëndësishme për të ndërtuar një themel të shëndoshë. Megjithatë, sfida më e madhe ishte procesi i gjatë dhe burokratik i regjistrimit gjyqësor. Ndërsa ligji parashikon që vendimi për regjistrimin të jepej brenda 15 ditësh, sot, për shkak të mbingarkesës së sistemit gjyqësor, procesi mund të zgjasë pa një kohë të përcaktuar. E njëjta situatë ndodh edhe për ndryshime në statut, përbërje bordin apo çdo informacion tjetër ligjor që kërkon miratim nga gjykata.

Ky realitet shpesh krijon ndjesinë e një teatri absurd dhe të pakuptimtë. Për këtë arsye, është thelbësore që kuadri ligjor të përmirësohet duke siguruar procedura më të shpejta dhe më transparente për regjistrimin dhe funksionimin e OJF-ve. Sepse në fund, janë komunitetet ato që ndejnë më shumë pasojat e zvarritjes së proceseve dhe mungesës së mbështetjes institucionale.

Si do t'i angazhoni donatorët dhe aktorët lokalë ne mbështetje të projekteve komunitare?

Angazhimi i donatorëve dhe aktorëve lokalë është një sfidë e vazhdueshme, por ne besojmë se është e realizueshme. Shqiptarët, pavarësisht mungesës së strukturave të organizuara filantropike, shquhen për bujarinë dhe zemërgjerësinë e tyre, edhe në kushte sfiduese sociale dhe ekonomike që kalojnë aktualisht.

Për të nxitur përfshirjen, synojmë të ndërtojmë një komunikim të drejtpërdrejtë me donatorët dhe aktorët lokalë, duke i bërë ata pjesë aktive të diskutimit dhe vendimmarrjes për projektet. Kontakti i afërt me komunitetin përfutës, prezantimi i nevojave konkrete dhe ndikimit real që kanë projektet, janë mënyra efektive për të krijuar ndjesi përkatësie dhe përgjegjësie. Transparenca është thelbësore për të ndërtuar besim afatgjatë dhe bashkëpunim të qëndrueshëm.

Si e shihni të ardhmen e filantropisë komunitare në Shqipëri? A mendoni se ky model mund të aplikohet në qytete të tjera?

Siç e theksova më herët, tradita filantropike në Shqipëri nuk është e re. Ajo pati një zhvillim të madh në fillim të shekullit XX, por u ndërpre gjatë periudhës së diktaturës. Tranzicioni i stërzgatur nuk krijoi kushte të favorshme për ringjalljen e kësaj kulture, megjithatë në vitet e fundit kemi parë përpjekje domethënëse nga OJF-të dhe aktorë të tjerë, si Partnerët Shqipëri, Banka Credins përmes Fondacionit Credins, Fondacioni Mane, e të tjerë, të cilët po luajnë një rol kyç në ringjalljen e filantropisë në vend. Besoj se me kalimin e kohës këto nisma do të gjejnë edhe më shumë mbështetjen e njerëzve të biznesit, por edhe individëve që dëshirojnë më të mirën për anëtarët e komunitetit të tyre.

Unë besoj se ky model mund të aplikohet me sukses edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Struktura relativisht homogjene e komuniteteve lokale krijon një terren të favorshëm për ngritjen e fondacioneve komunitare. Megjithatë, mungesa e donatorëve në fazën fillestare mbetet një pengesë reale. Për këtë arsye, është thelbësore ngritja e një mekanizmi kombëtar që ofron jo vetëm asistencë teknike, por edhe mbështetje financiare minimale për themelimin dhe funksionimin fillestar të këtyre iniciativave.

Mund të duket si një ide e avancuar, por koha ecën me ritme të shpejta dhe sfida më e madhe nuk është mungesa e burimeve, por mungesa e besimit. Çdo fillim është i vështirë, por jo i pamundur.

Në Tetor 2024, me mbështetjen e Partnerëve Shqipëri, fondacioni ynë mori pjesë në një vizitë studimore në kuadër të Konferencës Kombëtare të Fondacioneve Komunitare në Mbretërinë e Bashkuar. Po ashtu, në maj 2025 morëm pjesë në aktivitete të organizuara nga Fondacioni Komunitar "Roots and Wings" në Hungari, si pjesë e Iniciativës Evropiane për Fondacionet Komunitare (ECFI), së bashku me përfaqësues nga mbi 25 vende të Evropës. Si pjesë e këtyre organizmave kemi mundësinë të mësojmë dhe ndajmë përvoja me organizata homologe nga e gjithë Evropa. Nuk jemi vetëm në këtë rrugëtim.



Çfarë synoni të arrini në 3-5 vitet e ardhshme?

Synimi ynë kryesor është ndërtimi i një organizate funksionale dhe të qëndrueshme, me një stabilitet financiar dhe një rrjet të konsoliduar donatorësh, si nga rradhët e bizneset, ashtu edhe nga individë që do të mundësojnë realizmin e projekteve komunitare.

Prioritet do të kenë të rinjtë dhe të moshuarit, çështjet mjedisore, shëndeti dhe fusha të tjera, besojmë se do të jemi një faktor tejet pozitiv jo vetëm të sjellim ndryshim për komunitetin, por edhe ta fuqizojmë atë si aktor aktiv në këtë ndryshim. Por, le të jemi modestë e t'ia lejmë kohës të dëshmojë më qartë ecurinë tonë.

Në aspektin personal - Çfarë ju motivon personalisht për t'u angazhuar në këtë fushë?

Pavarësisht kësaj qasjeje të re në formë, kam qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me komunitetet ku kam jetuar. Eksperienca në mësimdhënie, gazetari dhe më pas angazhimi politik më kanë dhënë mundësinë ti njoh nga afër problematikat, shqetësimet dhe sfidat që përballen komunitetet në tërësi dhe ai korçar në veçanti.

Kontakti i drejtpërdrejtë me këto realitete, shpesh shumë të vështira e komplekse, si dhe dëshira për të kontribuar në zgjidhjen e tyre, përbëjnë një motivim të qëndrueshëm. Por, këtë herë, angazhimi vjen nga "llogoria" e shoqërisë civile. Përjasjet e qasjet janë të një forme tjetër, por thelbi kur ka dëshirë dhe vullnet të mirë nuk ndryshojnë.

Unë besoj fort se sa më shumë individë të formuar profesionalisht dhe të ndërgjegjshëm shoqërisht të ketë një komunitet, aq më të mëdha janë mundësitë për të ndërtuar një jetë me cilësi më të lartë. Sa më e lartë të jetë kjo cilësi, aq më të organizuar dhe të qëndrueshëm bëhen vetë komunitetet, për ta ruajtur, forcuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Dhe kjo dëshirë apo synim është motivimi im kryesor.

Çfarë këshille do t'i jepnit të rinjve që duan të kontribuojnë për komunitetin e tyre?

Përgjithësisht jam natyrë që shmang këshillat, sepse e konsideroj një fjalë të madhe, por sugjerime, po. Të rinjtë nuk janë thjesht një grupmoshë apo një target demografik. Ata janë shumë më tepër: janë energjia, potenciali dhe e ardhmja e një kombi.

Një komb merr kuptim kur jeton në një territor të caktuar, ku njerëzit ndërtojnë jetën, familjen dhe të ardhmen e tyre. Sugjerimi im për të rinjtë është që të kontribuojnë aty ku janë rritur, aty ku kanë rrënjët, sepse duke ndërtuar komunitetin e tyre, ata ndërtojnë njëkohësisht të ardhmen e tyre dhe të brezave që vijnë pas. Duhet të kemi kurajën të ndërtojmë jetën aty ku na ka "le koka". Është e vështirë, pa dyshim, por jo e pamundur.

As liria, as të drejtat, as cilësia e jetës nuk dhurohen, por fitohen. Ikja është një e drejtë legjitime e çdo individ, por jo gjithmonë është zgjidhja. Kontributi i pakushtëzuar për komunitetin është një ndër premisat kryesore, një shkollë e vërtetë jete që mundëson në ndërtimin e së ardhmes aty, është një gur themeli për një të ardhme më të mirë e jetë sa më cilësore.



F U S H A T A
N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E
N Ë N E V O J Ë

Fushata

Disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve janar - qershor 2025.

#1

Në qytetin e Peshkopisë, familja Markja me shtatë fëmijë jetimë ka përjetuar një ndryshim të madh pas një periudhe të vështirë që pasoi humbjen tragjike të kryefamiljarit në një aksident në punë.

Falë ndihmës së një shqiptari që jeton jashtë vendit që mori përsipër financimin e plotë të ndërtimit të një shtëpie të re, familja ka tashmë një strehë të sigurt dhe të denjë.

Ky akt solidariteti ka sjellë shpresë dhe qetësi në jetën e tyre.



NJË STREHË E RE

#2

Nxënësit dhe stafi i Tirana International School – QSI kanë dhuruar 900 kg ushqime, të cilat janë shpërndarë për rreth 40 familje në nevojë.

Përveç ndihmës materiale, ata janë angazhuar edhe si vullnetarë pranë Food Bank Albania, duke dhënë një shembull domethënës të solidaritetit dhe përkushtimit ndaj komunitetit.

900 KG MIRËSI



#3

Fondacioni ALSAR dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TİKA) kanë bashkëpunuar në kuadër të një fushate humanitare gjatë muajit të Ramazanit, duke shpërndarë 3,500 pako ushqimore për fëmijët jetimë në disa qytete të vendit.

Kjo fushatë ka pasur në fokus mbështetjen e familjeve në nevojë dhe lehtësimin e barrës së tyre gjatë kësaj periudhe të rëndësishme.

JETIMËT NË ZEMËR TË
RAMAZANIT



ART NË SYTË E ËNDRRAVE



#4

Në galerinë e artit të qytetit të Fierit u organizua ekspozita “Art në sytë e ëndrrave”, ku u përfshinë 40 gra dhe vajza nga Shqipëria dhe diaspora. Përmes pikturave, skulpturave dhe punimeve të tjera artistike, ekspozita vlerësoi figurën e gruas dhe sakrificat e saj në jetën e përditshme.

Kjo ngjarje artistike shërbeu si një urë bashkëpunimi mes grave artiste, duke ofruar një platformë për shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimeve të tyre. Ekspozita, që u mbështet nga Credins Bank, qëndroi e hapur për publikun deri më 31 mars.

SIGURIA DIGJITALE



#5

Studimi i fundit i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, me mbështetjen e One Albania, zbuloi se 1 në 5 të rinj shqiptarë përballen me bullizmin kibernetik në mediat sociale dhe platformat online.

Për të adresuar këtë sfidë, One Albania krijoi platformën OneSafe, që ofron mbrojtje ndaj përmbajtjeve të dëmshme, siguri për pajisjet e lidhura dhe kontrollë prindërore për përdorimin e internetit nga fëmijët.

F O N D A C I O N E T K O M U N I T A R E

Fondacionet Komunitare janë organizata jofitimprurëse që mobilizojnë burime lokale për të mbështetur iniciativa dhe projekte që adresojnë nevojat e komunitetit. Ato luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të atij komuniteti, duke promovuar filantropinë dhe pjesëmarrjen qytetare.

INFRASTRUKTURA PËR TË ARDHMEN

Nga 8 deri më 10 prill, në Rumani u organizua takimi global **“Infrastruktura për të Ardhmen”**. Kostandina Këruti, Menaxhere Programi pranë PSh ndoqi takimin në të cilin u mbledhën së bashku 102 organizata mbështetëse të fondacioneve komunitare nga 34 vende dhe 4 kontinente. Takimi u zhvillua në një moment të rëndësishëm për komunitetin global, ku ndryshimet politike, shoqërore, ekonomike dhe klimatike po prekin thellësisht realitetet lokale. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit

ndanë përvoja, sfida dhe praktika frymëzuese për të forcuar rolin e fondacioneve komunitare si motorë të zhvillimit afatgjatë dhe gjithëpërfshirës

Diskutimet u fokusuan përtej praktikave tradicionale të mbështetjes filantropike, duke hapur rrugë për pyetje mbi drejtimin që duhet të marrë ky sektor në të ardhmen. Përmes dialogut të hapur dhe ndërveprimit, u theksua rëndësia e reflektimit të përbashkët dhe e ndërtimit të një inteligjence kolektive që vë në qendër individin dhe komunitetin.



Një mesazh kyç që u përcoll gjatë takimit ishte nevoja për një qasje më krijuese dhe përfshirëse në ndërtimin e komuniteteve ku secili individ ndjen përkatësi dhe rol aktiv.

Imagjinata u trajtua si një mjet thelbësor për të zgjeruar kufijtë e asaj që fondacionet komunitare mund të arrijnë në nivel lokal dhe global. Po ashtu, u theksua edhe dimensionimi personal i angazhimit në këtë fushë, duke gjetur qëllim dhe motivim përmes mbështetjes së burimeve lokale dhe fuqizimit të njerëzve që ndërtuan dhe vazhdojnë të japin kontribut përmes këtyre fondacioneve.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim si pjesë e komunitetit ndërkombëtar të organizatave

që mbështesin infrastrukturën e filantropisë, vijon të angazhohet për të sjellë praktikën më të mirë në Shqipëri, për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse, aktive dhe të qëndrueshme.



Z H V I L L I M E T N G A R R J E T I W I N G S

WINGS është një forum për zgjidhje bashkëpunuese të problemeve, ku aktorët më të spikatur të ekosistemit mbi zhvillimet filantropike mund të ndajnë informacion dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Rrjeti numëron më shumë se 180 organizata anëtare që shtrihen në 57 shtete, dhe Partnerët Shqipëri është organizata përfaqësuese për Shqipërinë.

Solidariteti i filantropisë për ata që preken nga shkurtimeve të ndihmës së huaj

WINGS dhe rrjetet filantropike ndërkombëtare, shprehin shqetësimin për ndikimin e shkurtimeve të ndihmës së huaj mbi komunitetet më vulnerabël dhe theksojnë nevojën për solidaritet dhe veprim të përbashkët. Ata propozojnë një qasje të përqendruar në forcimin e ekosistemeve lokale dhe ndihmën e shoqërisë civile për të përballuar sfidat e reja. Sipas WINGS, ky është një moment për të rindërtuar sisteme më të drejta dhe të qëndrueshme për solidaritet dhe zhvillim ndërkombëtar. Gjeni si më poshtë deklaratën e Rrjetit:

Solidariteti i filantropisë për ata që preken nga shkurtimeve të ndihmës: Një thirrje e përbashkët për veprim.

Si rrjete të përkushtuara ndaj fuqizimit dhe transformimit të solidaritetit dhe kulturës së dhurimit në mbarë botën, duke përfaqësuar më shumë se 100,000 aktorë filantropikë, jemi thellësisht të shqetësuar për prirjen e fundit të shkurtimeve të mëdha në fondet e ndihmës, që po lënë pas miliona njerëz ndër më të cenueshmit në botë.

Vetëm reduktimi me 90% i programeve të ndihmës së jashtme nga USAID dhe Departamenti i Shtetit kap vlerën e rreth 60 miliardë dollarëve, duke përbërë një mungesë prej 25-30% të gjithë Ndhimës Zyrtare Globale për Zhvillim (ODA). Edhe disa qeveri evropiane kanë paralajmëruar shkurtime të ngjashme, duke e zhvendosur fokusin e buxheteve nga ndihma drejt çështjeve të tregtisë dhe mbrojtjes.

Ne qëndrojmë në solidaritet me miliona njerëz të prekur dhe angazhohemi të përdorim rrjetet dhe ndikimin tonë për të vepruar së bashku si një sektor i bashkuar filantropik.

Shqetësimet tona: Nga partnerët tanë në shoqërinë civile kemi dëgjuar shqetësime serioze për përkeqësimin e krizës humanitare, dobësimin e drejtësisë sociale, përshkallëzimin e pasojave klimatike, rënien e besimit tek shoqëria civile dhe sfidat ndaj sundimit të ligjit. Këto janë alarmante dhe kërkojnë vëmendje të menjëhershme.



Mundësia që kemi përpara: Pavarësisht sfidave të mëdha, kjo periudhë përbën një mundësi të rëndësishme për të rindërtuar së bashku sisteme më të drejta dhe të qëndrueshme për solidaritet dhe zhvillim ndërkombëtar. Bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve, shoqërisë civile lokale dhe ndërkombëtare, donatorëve publikë dhe sektorit filantropik mund të sjellë ndryshime reale. Duke vënë në qendër zërin dhe rolin aktiv të komuniteteve, mund të ndërtojmë ekosisteme të forta që mbështesin nismat lokale, forcojnë organizatat vendore dhe krijojnë partneritete të qëndrueshme për të arritur ndikim të përbashkët dhe afatgjatë.

Roli ynë unik si sektor filantropik: Filantropia kontribuon çdo vit me rreth 70 miliardë dollarë – rreth 8% të burimeve globale që kalojnë kufijtë. Por, roli ynë shkon përtej financimit: pavarësia jonë, gatishmëria për të marrë rreziqe dhe lidhjet e ngushta me komunitetet na japin një mundësi dhe përgjegjësi të veçantë për të ndikuar në ndërtimin e një sistemi më të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Edhe pse nuk mund të zëvendësojmë rolin e qeverive, ne mund të përdorim si burimet financiare, ashtu edhe ato jo-financiare, për të ndihmuar komunitetet dhe shoqërinë civile të përballojnë sfidat dhe të ndërtojnë modele të qëndrueshme zhvillimi. Ne besojmë se krijimi i një sistemi më të drejtë dhe të udhëhequr nga vetë komunitetet kërkon që filantropia të bashkëpunojë më ngushtë, të ndërmarrë rreziqe të menduara mirë, të ndërtojë besim dhe të investojë në ekosistemet lokale për të maksimizuar ndikimin tonë të përbashkët.

Philanthropy's
solidarity with those
impacted by aid cuts: A
joint Call to Action





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tiranë, Shqipëri